

Integrimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë

The background of the lower half of the page is a dense, overlapping pattern of stylized human silhouettes in various shades of yellow, orange, and red. The silhouettes are of different shapes and sizes, representing a diverse group of people.

Raport monitorues

Tetor – Dhjetor, 2018

* Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit "Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020 të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, i zbatuar nga Qendra për Arsime të Kosovës (KEC) në partneritet me Balkan Sunflowers (BSFK), Syri i Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC). Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

Tabela e përmbajtjes

HYRJE	6
1. Qëllimi i këtij raporti	7
2. Metodologjia	9
PRAPAVIJA KONTEKSTUALE	10
STATUSI I TANISHËM I ZBATIMIT TË MASAVE STRATEGJIKE	13
1. Pjesëmarrja në arsim	13
2. Sjellja e nxënësvenëshkollë dhe progresi i mësimit	15
3. Cilësia e mësimit të nxënësve	17
4. Zhvillimi i praktikës së mësimitdhënësve	19
VËREJTJET PËRMBYLLËSE	20

HYRJJE

Të drejtat e komunitetit, barazia dhe multikulturaliteti janë elemente kyçe të funksionimit të shoqërisë kosovare. Në mesin e tyre, të drejtat e komuniteteve të marginalizuara, përkatësisht komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, janë përcaktuar si dimensione të rëndësishme të avancimit të këtyre elementëve shoqërore. Procesi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit është adresuar nëpërmjet një pakoje të ligjeve dhe dy strategjive. Strategjia për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 e miratuar në vitin 2017 nga Qeveria e Kosovës, e parasheh arsimin si një nga katër shtyllat e integritit. Në fushën e arsimit, ka një numër aktivitesh të cilat janë paraparë të adresohen në vitet e ardhshme. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021 parasheh masa konkrete për rritjen e pjesëmarrjes dhe cilësinë e arsimit për komunitetet e marginalizuara me një fokus në fëmijët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Me mbështetjen e projektit KEEN të financuar nga BE si dhe projektit KOSINT, u zhvillua një kornizë për monitorimin e zbatimit të strategjisë (duke iu referuar PSAK 2017-2021). Kjo kornizë ka për qëllim të lehtësojë procesin e monitorimit dhe gjithashtu ka shërbyer në dizajnimin e këtij hulumtimi dhe hartimin e këtij raporti monitorues. Duke pasur parasysh parimet e kornizës së monitorimit, ky raport i tanishëm më shumë është përqendruar në zbatimin e masave (aktiviteteve) sesa në arritjen e objektivave. Arritja e objektivave të Strategjisë për integrimin e komunitetrom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 dhe PSAK 2017-2021 do të duhet të bëhet në një fazë të mëvonshme kur ka më shumë të dhëna dhe gjithashtu hapësirë për më shumë të dhëna cilësisë që dalin nga përvoja e përfituesve përfundimtarë si dhe nga palët e interesit duke përfshirë akterët në zbatimin e objektivave të strategjisë. Anë pse, mund të thuhet se pas pothuajse dy viteve të zbatimit mund të ketë gjurmë të arritjes së objektivave dhe ndikimit eventual, megjithatë kjo nuk është vlerësuar e përshtatshme për këtë vit dhe arsyet do të kuptohen në pjesën e gjetjeve të cilat kanë të bëjnë kryesisht me disponueshmërinë dhe thellësinë e të dhënave.

Duhet të theksohet se PSAK 2017-2021 flet për integrimin e tre komuniteteve (rome, ashkali, egjiptiane), ndërsa Strategjia për integrimin e romëve dhe ashkalive 2017-2021 nuk përfshin komunitetin egjiptian. Prandaj, përdorimi në këtë raport është përafëruar me atë se si janë përdorur në dokumentin strategjik përkatës.

1. Qëllimi i këtij raporti

Ky raport është përgatitur si një përpjekje për të ndjekur zbatimin e Strategjisë së integritit të komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2017-2021), me fokus të qartë në dimensionin e arsimit. Veç kësaj, raporti i monitorimit përfshin gjithashtu masat dhe aktivitetet e pjesëve të PSAK 2017-2021 për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për periudhën 2017-2021. Megjithatë aktivitetet e dy strategjive mbulojnë njëra-tjetrën, ekzistojnë specifika që ndryshojnë, prandaj raporti i monitorimit jep shpjegime të cilat ndihmojnë në bërjen e dallimit midis dy rasteve sipas nevojës.

Strategjia	Aktivitetet	Rezultatet e pritura
Strategjia për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021	<ul style="list-style-type: none">• Nxitja e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor.• Hartimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjeve dhe mos-regjistrimit në të gjitha komunat.• Nxitja e masave për lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm dhe të lartë.• Hartimi i planeve të individualizuara të edukimit për nxënësit e riatdhesuar.• Zhvillimi i masave specifike pozitive dhe programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në IAL.• Mbështetje për programet e edukimit për të rritur• Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor për SMIA për anëtarët e komunitetit rom dhe ashkali.• Eliminimi i segregacionit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve të komunitetit rom dhe ashkali.• Mbështetje për qendrat mësimore të bazuara në komunitet• Sigurimi i mësimin plotësues për nxënësit që hasin vështirësi në nxënie.• Promovimi i mësimin të gjuhës rome• Zhvillimi i programeve ndërgjegjësuere për prindërit në lidhje me fëmijërinë e hershme.• Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere të komunitetit rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit në kohë dhe të vijimësisë së shkollës, veçanërisht duke u përqendruar tek vajzat.• Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës së përgjithshme lidhur me edukimin e komunitetit rom dhe ashkali.	<ul style="list-style-type: none">• Pjesëmarrje e përmirësuar në arsimimin e pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali.• Përmirësim i performancës së nxënësve të komunitetit rom dhe ashkali.• Rritja e ndërgjegjësimit ndërmjet palëve të interesuara për të mbështetur arsimimin e pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali.

- Harmonizimi i programeve të qendrave mësimore
- Zhvillimi i rregulloreve në nivel komunal për të lehtësuar regjistrimin e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor dhe të mesëm
- Dhënia e bursave për nxënësit të cilët ndjekin shkollat e mesme nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian
- Monitorimi i zbatimit të masave lehtësuese nga MASHT
- Trajnimi i mësuesve në mësimdhënien e gjuhës rome
- Organizimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për regjistrimin dhe vijimin në shkollë, sidomos vajzave
- Krijimi dhe zbatimi i planeve vjetore për nxënësit e riadhesuar në fusha të caktuara
- Botimi i materialeve të rishikuara për nxënësit e riadhesuar

Është e rëndësishme të theksohet se raporti është shkruar në frymën e raportimit të realiteteve në terren dhe progresit të aktiviteteve zbatuese dhe arritjes së objektivave të parapara në dokumentet strategjike sesa në një hulumtim i cili sjell perceptimet e njerëzve të cilët konsiderohen si përfitues të ndërhyrjeve të këtyre strategjive. Ekziston një dallim i rëndësishëm mes dy qasjeve dhe është e rëndësishme të theksohet ky dallim, pasi që në njëfarë pike hulumtimi i tillë duhet të kryhet për të parë ndikimin e ndërhyrjes së strategjisë në jetën dhe përvojat e njerëzve të cilët mbështeten.

Ky raport monitorimi merr një qasje praktike të marrjes së aktiviteteve të strategjisë dhe shndërrimin e tyre në tregues për mbledhjen e të dhënave. Rrjedhimisht, instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave ishin të lidhura ngushtë me këta tregues dhe kështu duhet të prezantohet dhe përdoret ky raport.

2. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë vlerësim të progresit të bërë në zbatimin e aktiviteteve për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare, me përqendrim në arsim, kombinohet duke u bazuar në të dhënat nga raportet dhe statistikat në dispozicion në nivel kombëtar dhe nivel komunal në një rën anë dhe të dhënat e mbledhura nga komunat dhe MASHT për qëllime të këtij vlerësimi të veçantë në anën tjetër. Raportet që u analizuan për të mbledhur të dhëna për këtë vlerësim përfshinin:

- Raportet statistikore të MASHT për vitin 2016, 2017 dhe 2018 (të cilat dalin na divizioni SMIA);
- Raporti i KOSINT për Qendrat e Mësimorei përgatitur në vitin 2018;
- Raportet e brendshme nga Divizioni për Komunitete për aktivitetet e kryera;

Ndërkaq, të dhënat nga komunat dhe MASHT-i janë mbledhur përmes një ankete e cila ishte hartuar në konsultim me një grup të fokusit të organizuar nga projekti KOSINT, duke sjellë së bashku një grup të akterëve për të përcaktuar metodologjinë e këtij vlerësimi. Anketa përbëhej prej njësive të përziera duke përfshirë një opsion Po/Jo dhe një opsion pasues të shpjegimeve narrative, për çfarëdo përgjigjeje që u dha opsionit Po/Jo.

Një numër ekspertësh të fushës u përfshinë në mbledhjen e të dhënave nga terreni si partnerë të projektit KOSINT. Këto organizata partnere veprojnë në terren dhe punojnë në integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe janë më afër realiteteve në terren dhe rrjedhimisht edhe drejtoritë komunale të arsimit. Procesi filloi me një njoftim zyrtar të procesit dhe në të njëjtën kohë zyrtarit përkatës komunal iu dha një kopje e anketës në mënyrë që ata të përgatisin të dhënat e nevojshme. Në një kohë që eksperti dhe zyrtari përkatës në DKA ranë dakord, u zhvillua një takim pasues në formë intervistimi për të kaluar nëpër anketë dhe për ta përpunuar atë, kontrolluar dhe qartësuar çështjet eventuale që kërkonin sqarime në anketë apo në përgjigje. Anketat u përpunuan më pas dhe u analizuan për t'u raportuar në formë më të përmbledhur. Të dhënat nga MASHT janë mbledhur përmes takimeve me zyrtarët përgjegjës për arsimimin e komuniteteve dhe të dhënat dhe raportet shtesë janë siguruar në formë elektronike.

Dokumentet strategjike parashohin aktivitete për periudhën pesëvjeçare dhe mund të ndodhë që disa aktivitete të parapara për vitin 2019 nuk kanë filluar akoma, por në përgjithësi ky vlerësim ka tentuar të identifikojë gjithashtu çështjet e planifikimit dhe të menduarit të mundshëm në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të tilla. Në rastet kur ishte e qartë se asgjë nuk është bërë në vitin 2018 për një aktivitet të caktuar, kjo është treguar në raport si i tillë.

Të dhënat u raportuan në një formë që ndërton dhe konceptet u grupuan në tema të cilat përfaqësojnë dimensionet e funksionimit të sistemit shkollor. Përpunimi i të dhënave është bërë në lidhje me aktivitetet specifike të parapara në dokumentacionin e strategjisë.

PRAPAVIJA KONTEKSTUALE

Të dhënat për popullsinë e përgjithshme dhe ato të komuniteteve etnike vijnë nga regjistrimi i fundit i popullsisë i kryer në vitin 2011 (Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës). Tabela 1 më poshtë ofron një përshkrim të popullatës së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunat përkatëse, si dhe popullatën e përgjithshme të komunës përkatëse. Një total prej 8,824 ose 0,5% të popullsisë së përgjithshme janë romë, 15,436 (që është 0,9% e popullsisë së përgjithshme) janë ashkalinjë dhe 11,524 (0.7% e popullsisë së përgjithshme) janë egjiptianë.

Tabela 1: Numri i përgjithshëm i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komuna

Komuna	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Totali	Popullata e përgjithshme e komunës
Deçan	33	42	393	468	40019
Gjakovë	738	613	5,117	6,468	94556
Glllogoc	0	0	2	2	58531
Gjilan	361	15	1	377	90178
Dragash	3	4	3	10	33997
Istog	39	111	1,544	1,694	39289
Kaçanik	5	1	0	6	33409
Klinë	78	85	934	1,097	38496
Fushë Kosovë	436	3,230	282	3,948	34827
Kamenicë	240	0	0	240	36085
Mitrovicë	528	647	6	1,181	71909
Lipjan	342	1,812	4	2,158	57605
Novobërdë	63	3	0	66	6729
Obiliq	661	578	27	1,266	21549
Rahovec	84	404	299	787	56208

Pejë	993	143	2,700	3,836	96450
Podujevë	74	680	2	756	88499
Prishtinë	56	557	8	621	198897
Prizren	2,899	1,350	168	4,417	177781
Skenderaj	0	10	1	11	50858
Shtime	23	750	0	773	27324
Shtërpcë	24	1	0	25	6949
Suharekë	41	493	5	539	59722
Ferizaj	204	3,629	24	3,857	108610
Viti	12	14	0	26	46987
Vushtrri	68	143	1	212	69870
Malishevë	26	5	0	31	54613
Mamushë	39	12	0	51	5507
Graçanicë	745	104	3	852	10675
Klllokot	9	0	0	9	2556
Hani i Elezit	0	0	0	0	9403
Partesh	0	0	0	0	1787
Ranillug	0	0	0	0	3866
Junik	0	0	0	0	6084
Gjithsej	8824	15436	11524	35784	1739825

Derisa këto komunitete janë të përhapura në të gjithë vendin, ato janë më të përqendruara në një numër komunash si Gjakova, Istogu, Klina, Fushë Kosova, Prizreni, Peja, Lipjani, Mitrovica e Ferizaji.

Në përgjithësi, baza ligjore për zhvillimin e sistemit arsimor vlerësohet të jetë mjaft e përparuar dhe në përputhje me pikat referente të praktikës më të mirë ndërkombëtare. Fusha e integritit të komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare, duke përfshirë arsimin, është gjithashtu e mbuluar mirë dhe e përparuar. Fakti që çështja e integritit është adresuar përmes një strategjie ombrellë në nivel kombëtar (Strategjia për integrimin e komunitetave dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021) dhe me një strategji sektoriale në arsim (PSAK 2017-2021) është një tregues i qartë për këtë. Për më tepër, e gjithë puna është e bazuar në një kornizë të fortë ligjore e cila mbështet përmirësimin e jetës dhe arsimimit të komuniteteve përkatëse. Përveç faktit se të drejtat themelore janë garantuar nga kushtetuta e vendit dhe të drejtat për arsim janë të bazuara në ligjin për arsimin para-universitar si legjislacion ombrellë në arsim, ekzistojnë edhe një numër ligjesh që drejtpërsëdrejti promovojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut:

- Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë (03/L-047);
- Ligji për arsimin në komuna i cili parasheh një përgjegjësi më të madhe për vendimmarrjen e nivelit lokal (03/L-068);
- Ligji kundër diskriminimit (2004/3);
- Ligji për përdorimin e gjuhëve (02/L37);
- Ligji për trashëgiminë kulturore (02/L-88);

Së këndejmi, Kosova përgjithësisht mund të konsiderohet si një vend që i ka dhënë një fokus të lartë promovimit të diversitetit dhe të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit e saj, pavarësisht racës, përkatësisë etnike apo fesë.

Ambicia e shoqërisë kosovare për të avancuar integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri në përgjithësi dhe në arsim në veçanti mund të shihet edhe në treguesit e synuar në PSAK 2017-2021 (shih tabelën më poshtë), e cila parasheh një rritjetë ndjeshme të pjesëmarrjes së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit.

Tabela 2. Treguesit për matjen e arritjes së objektivit të MASHT për përfshirje

Treguesit për matjen e arritjes së objektivit për përfshirje	Baza	Caku
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parafillor	53.9%	70%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor	85.3%	95%
Përfshirja e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të ulët	65%	85%
Përfshirja e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë	30.3%	50%
Shkalla e transicionit në arsimin e mesëm të lartë për nxënësit rom, ashkali	69.9%	80%

Burimi: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2020

Megjithatë, tani për tani është shumë e vështirë të vlerësohet arritja e këtyre caqeve. Baza është përcaktuar në Anketën e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë të kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2014 dhe nuk ka pasur ndonjë hulumtim të tillë përcjellës më pas. Pra, tregues të tillë mund të përcaktohen vetëm me të dhëna të besueshme mbi të dhënat e popullsisë dhe parashikimet, të cilat aktualisht nuk ekzistojnë. Megjithatë, këto caqe shërbejnë si një pikë e mirë referimi për të gjurmuar progresin e pjesëmarrjes në një fazë kur një anketë përcjellëse të jetë bërë.

STATUSI I TANISHËM I ZBATIMIT TË MASAVE STRATEGJIKE

1. Pjesëmarrja në arsim

Sa i përket pjesëmarrjes së nxënësve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në nivele të ndryshme të arsimit, duhet të vihet në dukje se shifrat duhet të merren parasysh në dritën e mungesës së të dhënave për parashikimet e popullatës. Në dritën e tendencës së përgjithshme të uljes së popullsisë studentore në Kosovë në përgjithësi, pjesëmarrja e studentëve nga këto komunitete (veçanërisht ashkalinjtë dhe egjiptianët) duket të jetë një prirje shumë premtuese. Ndërsa popullsia studentore shqiptare është zvogëluar nga viti 2017/2018 në 2018/2019, numri i studentëve nga këto komunitete është rritur. Numri i studentëve në komunitetet ashkali dhe egjiptiane ka shënuar rritje në të gjitha nivelet e arsimit. Ndërkaq, numri i nxënësve nga komuniteti rom ka parë gjithashtu një rritje në të gjitha nivelet, me përjashtim të klasave 1-9 (filllore dhe të mesme të ulëta).

Tabela 2. Treguesit për matjen e arritjes së objektivit të MASHT për përfshirje

Niveli	Shqiptar		Ashkali		Rom		Egjiptian	
	2018/19	2017/18	2018/19	2017/18	2018/19	2017/18	2018/19	2017/18
Arsimi parashkollor (mosha 0-<5)	8197	6505	1	0	20	10	4	0
Arsimi para-fillor(mosha 5-<6)	22783	22999	247	256	112	103	77	55
Fillor/i mesëm i ulët	228591	233239	3439	3218	1509	1733	847	742
Arsimi i mesëm i lartë	81892	87530	262	255	161	156	160	142
Gjithsej	341463	350273	3949	3729	1802	2002	1088	939

Komuniteti etnik	Numri		%	
	2018/19	2017/18	2018/19	2017/18
Shqiptar	341463	350273	95,84	95,96
Serb	482	500	0,14	0,14
Turk	2760	2756	0,77	0,76
Boshnjak	3797	3965	1,07	1,09
Goran	465	557	0,13	0,15
Ashkali	3949	3729	1,11	1,02
Rom	1802	2002	0,51	0,55
Egjiptian	1088	939	0,31	0,26
Kroat	23	26	0,01	0,01
Tjetër	441	282	0,12	0,08
Gjithsej	356270	365029	100,00	100,00

Tabela 2. Treguesit për matjen e arritjes së objektivit të MASHT për përfshirje

Sa i përket pjesëmarrjes së nxënësve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në nivele të ndryshme të arsimit, duhet të vihet në dukje se shifrat duhet të merren parasysh në dritën e mungesës së të dhënave për parashikimet e popullatës. Në dritën e tendencës së përgjithshme të uljes së popullsisë studentore në Kosovë në përgjithësi, pjesëmarrja e studentëve nga këto komunitete (veçanërisht ashkalinjtë dhe egjiptianët) duket të jetë një prirje shumë premtuese. Ndërsa popullsia studentore shqiptare është zvogëluar nga viti 2017/2018 në 2018/2019, numri i studentëve nga këto komunitete është rritur. Numri i studentëve në komunitetet ashkali dhe egjiptiane ka shënuar rritje në të gjitha nivelet e arsimit. Ndërkaq, numri i nxënësve nga komuniteti rom ka parë gjithashtu një rritje në të gjitha nivelet, me përjashtim të klasave 1-9 (filleore dhe të mesme të ulëta).

Universiteti	Boshnjakë	Turq	Romë	Ashkalinj	Egjiptianë	Goranë
Universiteti i Prishtinës "HasanPrishtina"	55	23	5	9	6	4
Universiteti i Pejës "HaxhiZeka"	49	1	1		9	
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	1	4				
Universiteti i Prizrenit "UkshinHoti"	229	192	3	4	7	
Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj				18		
Universiteti i Gjakovës "FehmiAgani"	6		2	3	5	
Gjithsej BA	340	220	11	34	27	4
Gjithsej MA	9	7	1	2	1	2
Qendra e studentëve	22	2	10	1	1	

Tabela 2. Treguesit për matjen e arritjes së objektivit të MASHT për përfshirje

Të dhënat nga MASHT kanë treguar se ka pasur 75 studentë nga tre komunitetet të cilët janë regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë në vitin akademik 2017/2018. Të dhënat nga viti akademik 2018/2019 nuk janë në dispozicion ende, por dihet se ofruesit e arsimit të lartë publik i kanë respektuar dispozitat për kuotat e rezervuara edhe gjatë këtij viti.

2. Sjellja e nxënësvenëshkollë dhe progresi i mësimit

Në kuadër të temës së pjesëmarrjes në shkollë dhe motivimit të studentëve për të vazhduar gjatë gjithë arsimit, ka pasur tre indikatorë kundër të cilëve u mbledhën të dhënat. Së pari, DKA-të dhe MASHT-i u pyetën për punën që bëhet në drejtim të ngritjes së vetëdijes së nxënësve, por më e rëndësishmja e familjeve, pjesëmarrjes dhe arsimit të vazhdueshëm. Dimensioni i dytë që është parashikuar në dokumentet strategjike ka qenë çështja e adresimit të rasteve të braktisjes së shkollimit dhe integritetit të nxënësve të riatdhesuar. Në lidhje me aktivitetet e ngritjes së vetëdijes, ky hulumtim ka pasur vështirësi në grumbullimin e të dhënave sasiore për aktivitetet që janë organizuar. Dy lloje përgjigjesh u pranuan. Njëri lloj i përgjigjeve kishte të bëjë me trajtimin e barabartë që tregon se fëmijët nga këto komunitete janë trajtuar në mënyrë të barabartë si çdo fëmijë tjetër në Kosovë dhe nuk ka pasur pengesa në sjelljen e njerëzve në shkollimin e detyrueshëm, në rast se ka pasur një interesim për këtë. Llojet e tjera të përgjigjeve, veçanërisht në komunat ku ka pasur një numër më të madh të fëmijëve nga këto komunitete, ishte pak më e shtjelluar duke theksuar se ekipet e shkollave me mbështetjen e projekteve të donatorëve ishin aktive në lagjet ku këto komunitete janë të përqendruara duke u përpjekur t'u bëjnë thirrje prindërve për nevojën e sjelljes dhe mbajtjes së fëmijëve në shkollë. Këto përgjigje kanë ardhur nga komunat e Fushë Kosovës, Lipjanite Suharekës.

Në formë më sporadike, komunat dhe MASHT raportojnë mbi broshurat dhe fletëpalosjet që ato përgatisin për nevojën e përfshirjes së sa më shumë fëmijëve të jetë e mundur nga këto komunitete në shkollë. Këto nuk duket se janë planifikuar në mënyrë sistematike (as nuk ekzistojnë statistika dhe të dhëna të besueshme), por prapëseprapë DKA-të e caktuara duket se u kushtojnë vëmendje këtyre gjërave brenda mundësive që ato kanë. DKA-të lavdërojnë OJQ-të dhe projektet e donatorëve se u kanë ofruar atyre mbështetje për të arritur deri tek këto komunitete.

Së dyti, në lidhje me parandalimin e braktisjes së shkollimit, të gjitha DKA-të nuk e vlerësojnë të rëndësishme që duhet të ketë parandalim specifik të braktisjes për komunitetet specifike dhe ato veprojnë me planet e përgjithshme të parandalimit të braktisjes brenda komunave dhe shkollave. Ato e njohin nevojën që në kuadër të zbatimit të planeve për parandalimin e braktisjes së komunave, ata do të adresonin rastet që u referohen nga shkolla dhe në shumtën e rasteve ata thonë se fëmijët e këtyre komuniteteve janë ata që marrin vëmendjen e tyre. Megjithatë, nuk ka pasur asnjë tregues për nevojën për të zhvilluar masa më konkrete se si të parandalohen rastet e braktisjes së shkollimit duke identifikuar kategorinë në rrezik dhe të shmangin trajtimin e rasteve kur ato tashmë konsiderohen raste që nuk janë në gjendje të adresohen nga shkolla. Tabelat e mëposhtme japin një përmbledhje të rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit (siç

raportohet nga MASHT SMIA) për dy vitet e fundit (2016/2017 dhe 2017/2018). Të dhënat për 2018/2019 ende nuk janë dhënë. Megjithatë, trendi nga dy vitet e fundit duket të jetë një trend pozitiv. Numri i braktisjeve të raportuara të shkollimit ka rënë për të tre komunitetet. Nga gjithsej 119 nxënës të cilët braktisën shkollimin në vitet 2016/2017 numri u zvogëluar në 88 në vitet 2017/2018.

Procesi i monitorimit të braktisjes së shkollimit nga nxënësit shoqërohet me defekt në menaxhimin dhe interpretimin e të dhënave në MASHT. Sistemi nuk ndjek në hollësi lëvizjet e nxënësve nga një komunë në tjetrën në rastet kur familjet shpërngulen.

Niveli	Ashkalinj			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T
Fillor dhe i mesëm i ulët(1 – 9)	26	28	54	12	2	14	3	3	6	41	33	74
I mesëm i lartë (10 – 12)	0	0	0	2	1	3	11	0	11	13	1	14
Gjithsej	26	28	54	14	3	17	14	3	17	54	34	88

Tabela 6. Nxënësit të cilët braktisën shkollimin bazuar në prapavijën etnike dhe gjininë në vitet 2017/18

Niveli	Ashkalinj			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T
Fillor dhe i mesëm i ulët(1 – 9)	40	21	61	4	3	7	19	13	32	63	37	100
I mesëm i lartë (10 – 12)	0	0	0	8	11	19	0	0	0	8	11	19
Gjithsej	40	21	61	12	14	26	19	13	32	71	48	119

Tabela 7. Nxënësit të cilët braktisën shkollimin bazuar në prapavijën etnike dhe gjininë në vitet 2016/2017

Së fundmi, PSAK parashih hartimin e rregulloreve të cilat lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe atë të mesëm të lartë. Të dhënat e mbledhura tregojnë se asnjë komunë nuk ka ndërmarrë ndonjë masë konkrete për krijimin e rregulloreve të tilla. DKA-të e konsultuara thonë se nuk ka nevojë për rregullore të tilla, pasi që në përgjithësi njerëzit kanë qasje dhe se ata që dëshirojnë të vazhdojnë shkollën e mesme të lartë do t'u ofrohet kjo mundësi. Megjithatë, kjo çështje e ofrimit të mundësisë duket se bazohet më shumë në vullnetin e mirë, sesa në ndonjë proces a mekanizëm. Pika e rëndësishme këtu, në lidhje me vazhdimin e shkollës së mesme të lartë, bëhet çështje e orientimit të studentëve në profilin e duhur të arsimit të mesëm të lartë. MASHT raportoi se në vitin shkollor 2018/2019 Ministri i Arsimit ka nxjerrë një vendim për të siguruar kuota për studentët e këtyre komuniteteve në shkollat profesionale (5 studentë në secilin profil).

Në lidhje me mbështetjen për të motivuar njerëzit që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë dhe për ta vazhduar atë deri në fund, PSAK 2017-2021 ka paraparë një masë të ofrimit të bursave për nxënësit që shkojnë në shkollat e mesme. Të dhënat nga MASHT tregojnë se për studentët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët vazhdojnë shkollimin e mesëm të lartë, janë ofruar gjithsej 600 bursa (secila 300 euro). Në vitin paraprak (2017), MASHT ka ofruar 507 bursa. Pra, ekziston një trend në rritje dhe kjo duket se vendoset nga disponueshmëria e financimit të donatorëve për këtë fond të bursave.

Në lidhje me riatdhesimin e studentëve të cilët kthehen nga Evropa, MASHT ka raportuar për materialet që janë zhvilluar, siç janë doracakët. Në nivel komunal, çështja e mbështetjes së nxënësve të riatdhesuar trajtohet në baza ad hoc, sipas nevojës. Në përgjithësi, raportet nga komunat ishin se MED punon me zyrën e komuniteteve (në disa komuna të quajtur zyra për komunitete dhe kthim) me qëllim të përkrahjes së familjeve të riatdhesuara. Takimet dhe raportet treguan më shumë përkrahje në aspektin e akomodimit dhe të drejtave të tjera themelore siç janë vijimii shkollës, por nuk ka pasur ndonjë rast të raportuar kur studentët individualë ishin të pajisur me një plan individual të mbështetjes dhe integritit.

3. Cilësia e mësimin të nxënësve

Cilësia e të nxënësve në këtë raport është përdorur për të treguar se mësimi ndihmon nxënësit që t'ia dalin përmes mekanizmave të ndryshëm dhe në mënyrë të veçantë përmes aktiviteteve të Qendrave Mësimore (QM-ve). Dokumentet strategjike parashohin që gjithsej 15 QM duhet të themelohen në pesë vitet e ardhshme për të rritur mbështetjen për rajonet dhe komunitetet në nevojë. Komunat e përfshira në këtë hulumtim kanë raportuar se gjithsej 16 qendra mësimore janë themeluar në vitet 2017 dhe 2018. Kjo e ka arritur cakun e parashikuar për vitin 2019 në PSAK 2017-2021. Puna e komunitetit të donatorëve ka ndikuar që ky objektivi të arrihet lehtësisht falë mbështetjes bujare si të ndihmës financiare ashtu edhe teknike në krijimin dhe funksionimin e qendrave mësimore në të gjithë vendin. Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të komunave ku janë themeluar qendrat mësimore.

Komuna	2017	2018
Suharekë	3	
Gjakovë	2	2
Istog	3	2
Pejë	4	
Gjithsej	12	4

Tabela 8. Qendrat e reja mësimore të hapura në vitet 2017 e 2018

Gjatë intervistave, përfaqësuesit e DKA-ve kanë treguar një interesim të madh për punën e qendrave mësimore dhe ata kanë folur me shumë konsideratë për kontributin dhe cilësinë e punës që këto qendra kanë dhënë për ata që kanë nevojë për mbështetje shtesë. DKA-të kanë shprehur interesim për të hapur qendra të reja aty ku ekziston nevoja dhe gjithashtu të gjejnë mënyra për të inkorporuar funksionimin e këtyre qendrave brenda skemës së financimit komunal, në mënyrë që puna të përparohet dhe qëndrueshmëria të sigurohet në afat të gjatë. Kur u pyetën se çfarë është mbështetja konkrete që DKA-të ofrojnë për punën e Qendrave Mësimore, të gjitha DKA-të u përgjigjën se mbështetja e vetme që ata mund të ofrojnë është ofrimii hapësirës për qendrën mësimore që funksionon brenda mjediseve të shkollës. Nuk kishte dëshmi të tjera të mbështetjes shtesë të dhënë deri më sot dhe për këtë DKA-të flasin për kufizimet financiare që ato kanë.

Strategjia parasheh një masë konkrete për DKA-të cilat ofrojnë mbështetje në mësim për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë. DKA dhe MASHT treguan se mbështetja më e formalizuar që fëmijët mund të marrin është veprimtaria e ofruar nga Qendrat Mësimore të cilat veprojnë në komuna të veçanta. Nuk duket të jetë një nevojë që të ketë aktivitete apo mbështetje shtesë.

Në lidhje me punën e Qendrave Mësimore, MASHT ka shqyrtuar Udhëzimin Administrativ për Qendrat e Mësimore (Udhëzimi i ri u publikua në fund të vitit 2018) për të përparuar punën e qendrave. Udhëzimi siguron hapësirë për funksionimin e qendrave në komunitet dhe në shkollë dhe ofron standarde e procese për funksionimin e qendrës, stafit dhe programimit. Qendrat jo vetëm që do të shërbejnë për komunitetet e veçanta, por për të gjithë nxënësit të cilët kanë nevojë për përkrahje, pavarësisht prej prapavijës dhe veprimit brenda shkollës dhe në komunitet, ofron një model fleksibil për t'iu përgjigjur nevojave të lokaliteteve dhe komuniteteve të veçanta që jetojnë në to.

4. Zhvillimi i praktikës së mësimdhënësve

Nën këtë dimension të mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë bërë bashkë disa tregues. Ky dimension përfshinë elementet e: (i) zhvillimit profesional të mësimdhënësve për mësimin e gjuhës rome, (ii) zhvillimin profesional të mësimdhënësve për gjuhën shqipe si gjuhë të dytë, (iii) të ketë një politikë mbi mësimin e diversitetit dhe të drejtave të njeriut për të gjitha komunitetet në shkollë, dhe (iv) krijimi i materialeve mësimore që mund të ndihmojnë mësimin e nxënësve nga komunitetet. Këto aktivitete strategjike kanë qenë ato që duket se konsiderohen të dorës së dytë për të rritur vijimin e shkollimit në bazë të të dhënave të ofruara nga komunat dhe MASHT-i dhe të dhënat që dalin nga mbledhjet e mbajtura. Nga të gjitha këto aktivitete të planifikuara, MASHT raportoi se ka pasur një trajnim të organizuar, dhe nga pesë pjesëmarrës të pritur, vetëm dy kanë marrë pjesë.

Një fakt i rëndësishëm është të theksohet niveli i vetëdijesimit dhe të menduarit që është vënë re në nivel komunal për disa nga aktivitetet e strategjisë. Ani pse jo gjithçka pritej të ndodhte në dy vitet e para, prapëseprapë është e rëndësishme që para-planifikimet e nevojshme dhe mirëkuptimi i nevojave ekzistojnë. Së këndejmi, nuk ka asnjë pasur tregues se do të bëhet puna për krijimin e materialeve mësimore si dhe nevojën për zhvillim profesional të mësimdhënësve që është parashikuar në dokumentet strategjike. Aktiviteti për zhvillimin e një politike për mësimdhënien e diversitetit dhe të drejtave të njeriut në shkollë ishte gjithashtu ndër ato që ngritën pyetje rreth asaj se sa janë kuptuar aktivitetet në planet strategjike dhe janë 'në pronësi' nga ata që duhet t'i zbatojnë. Në takime, DKA-të treguan se diversiteti dhe të drejtat e njeriut janë koncepte që trajtohen nga praktika e përditshme dhe zbatimi i plan-programit.

Për çështjet e tilla si këto që tregojnë më shumë se një nevojë për të shkruar vetëm një politikë, është e nevojshme që të bëhet një punë anash për të përcaktuar kuptimin dhe procesin që kërkon një aktivitet. Për shembull, çështja e politikës mbi mësimin e diversitetit dhe të drejtave të njeriut në shkollë është një çështje e ndërlikuar dhe duhet të shpërndahet në thellësi më të madhe në nivelin komunal dhe në mënyrë që kjo të ndodhënevojitet ndihmë e menjëhershme teknike. Më shumë se sa të shkruash një rregullore të shkurtër mbi diversitetin dhe të drejtat e njeriut, është një koncept programi mësimor si dhe një element i identitetit dhe praktikës profesionale të mësuesit. Prandaj, çështja duhet të trajtohet nga perspektiva e ndërlikueshmërisë që ka për të shmangur një rregullore që përkrah parime dhe ide të caktuara pa ndonjë rëndësi praktike. Përderisa ky zhvillim është parashikuar për vitin 2020 ende nuk ka dëshmi të planifikimit dhe të të menduarit aktualisht dhe ky nuk është një aktivitet që mund të zbatohet lehtësisht vetëm brenda një viti.

VËREJTJET PËRMBYLLËSE

Qëllimi i këtij raporti monitorues ishte të përcjellë përparimin në zbatimin e masave strategjike në dy dokumente strategjike (Strategjia për Integrimin e Romëve dhe Ashkalinjve në Shoqërinë Kosovare 2017-2021; Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017-2021) sa i përket përparimit në arritjen e objektivave për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane në sektorin e arsimit në Kosovë. Ky raport ka mbledhur të dhëna nga komunat dhe MASHT si dhe ka shfrytëzuar shqyrtimin e të gjitha të dhënave e statistikave në dispozicion të cilat ndihmojnë gjykimin për përparimin e bërë.

Raporti ka identifikuar përparimin e bërë si dhe masat theksuan sfidat të cilat ende duhet të adresohen. Raporti arrin në përfundimin se pjesëmarrja e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë është shumë premtuese dhe se një trend pozitiv mund të vërehet. Përveç statistikave, takimet dhe intervistat me autoritetet komunale kanë treguar se situata po përmirësohet edhe në lidhje me interesin e familjeve për arsimin e fëmijëve të tyre. Këtatrendë nuk mund të gjykojnë për mënyrën se si pjesëmarrja në arsim po rritet në dritën e tendencave demografike për shkak të mungesës së të dhënave me kohë dhe të besueshme. Në takimet me autoritetet komunale, nuk ka qenë e mundur të identifikohen përpjekjet e bëra në nivel komunal për të rritur nivelin e pjesëmarrjes së nxënësve e as nuk është raportuar ndonjë e dhënë në monitorimin e braktisjeve individuale të rasteve të mos-vijimit të shkollimit.

Krahas pjesëmarrjes, Kosova ka bërë përparim në shtrirjen e mbështetjes së të mësuarit për nxënësit përmes punës së qendrave mësimore. Është krijuar një numër i madh i qendrave mësimore dhe funksionimi i tyre është formalizuar e operacionalizuar me anë të akteve nënligjore nga MASHT-i. Komuniteti i donatorëve për fat të mirë ka vazhduar të mbështesë këto qendra mësimore dhe ndërkohë që komunat duhet të gjejnë mënyra për të mbështetur punën e këtyre qendrave, të paktën ato brenda shkollës. Deri më sot, nuk ka dëshmi në nivelin komunal për çështjen e rëndësishme të mësimin të nxënësve. Porsa të garantohet pjesëmarrja, mësimi i nxënësve bëhet qenësor në dritën e sfondeve të ndryshme të nxënësve dhe mbështetjes së mësimin të ofruar. Puna e ardhshme duhet të orientohet drejt dimensionit të të nxënësve në mënyrë që të jemi në gjendje të përcjellim përparimin e nxënësve, veç pjesëmarrjes. Kjo mund të përfshijë arsimimin në shkollë dhe në qendrat mësimore. Këto të dhëna mund të mblidhen në një farë mase edhe në kuadër të zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike, me qëllim të vendosjes se në ç' masë janë arritur objektivat e integritit dhe mësimin cilësor. Komunat nuk duket të jenë të lidhura ngushtë me veprimtarinë e qendrave mësimore dhe kjo bëhet vendimtare për të siguruar që të gjithë nxënësittë përfitojnë nga mbështetja e të mësuarit.

Deri më tani, elementët e zhvillimit të praktikave të mësimdhënësve nuk janë adresuar në nivelin e mbështetjes së shkollave për të adresuar diversitetin, përfshirjen e nxënësve me prapavija të ndryshme në shkollat e rregullta dhe në aspektin e mësimdhënies në lidhje me diversitetin. Këto janë çështje që janë më profesionale dhe atyre u duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje në vitet e ardhshme nëpërmes projekteve më sistematike të cilat adresojnë çështjen në mënyrë më thelbësore dhe të qëndrueshme në mënyrë që nxënësit nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të përfitojnë nga mjediset mësimore mbështetëse në shkolla.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave për këtë studim, u bë e qartë se në nivelin komunal nuk ka procese të përdorimit të inputeve strategjike qendrore në veprimet komunale. Aktivitetet në nivel komunal kryesisht mbështeten nga partnerët e zhvillimit, ndërsa autoritetet komunale janë më të përqendruara në dimensionin e pjesëmarrjes, që është një tregues i rëndësishëm në vetvete, por ka nevojë për të shkuar më tej. Kjo flet për sfida serioze në dimensionin e kapaciteteve në nivel komunal për të ndërmarrë siç duhet nismat e zhvillimit të burimeve me qëllim të ofrimit të arsimit cilësor për fëmijët e këtyre komuniteteve. Duhet të pranohet se pjesëmarrja nuk është e barabartë me përfshirjen, ndërsa përfshirja nuk mund të matet me praninë fizike në mjedisin e duhur, por përmes përvojave pozitive të studentëve në ato mjedise. Kjo mbetet një cak i këtyre dokumenteve strategjike, ndërsa të gjithë akterët në terren duhet të punojnë së bashku për të siguruar që përparimi të arrihet duke punuar ngushtë me shkollat dhe qendrat mësimore për të siguruar që nxënësit të jenë në qendër të veprimeve të të gjithë akterëve të përfshirë.



**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**

Roma Initiatives Office

